

Arta Hallaçi

REZYMEJA E ZGJERUAR

Ky disertacion hulumton kontrollimin narrativ përmes strategjive të përdorura nga rrëfimtaret e vetës së parë të narracionit tradicional dhe narracionit modern. Pas përcaktimit të këtyre strategjive të përdorura për kontrollim të informatave përbrenda narracionit tradicional, në këtë hulumtim do të testohet nëse strategjitë e njëjta përdoren edhe te veprat narrative moderne. Do të testohen nëse këto strategjitë do të kenë funksion të njëjtë edhe te veprat me narracion modern. Më pas, hulumtimi do të hapet përtej kufizimeve të narratologjisë klasike duke propozuar mundësinë e analizës narratologjike dhe gjetjes së strategjive të ngjashme për kontrollim të narracionit në leximin e një zhanri poetik, monologut dramatik. Fokusi i ngushtë i këtij disertacioni janë elementet dhe/apo teknikat narrative të quajtura strategji, të cilat janë: krijimi i identitetit fiksional, projektimi i identitetit fiksional përmes aktit të të rrëfyerit, theksimi i aktit të rrëfimit, kontrollim i informatave përmes paralipsis dhe prolepsis, dualiteti narrativ në mes të unit rrëfyes (*narrating I*) dhe unit përjetues (*experiencing I*), distanca kohore, zgjedhjet diskursive, dhe konstruktet mendore të lexuesit aktual.

Strategji në këtë hulumtim konsiderohet një metodë apo taktikë e cila planifikohet me kujdes dhe me qëllime të caktuara nga ana e një rrëfimtari. Emërtimi ‘narracion tradicional’, siç përdoret në këtë doktoratë, i referohet llojeve të rrëfimeve të shkruara përgjatë shekullit të 19-të, ku rrëfimtari pretendon pronësi të aktit narrativ, përdor një zë autoritativ përgjatë narracionit, dhe një lloj narrativi i cili kryesisht ndjek linjë kronologjike të prezantimit të ngjarjeve fiksonale, të kontrolluara kështu nga një rrëfimtari i cili ka qëllim një tregimtari didaktike – një tip narracioni të modeluar sipas rrëfimit viktorian të vetës së parë. Ndërkaq, emërtimi ‘narracion modern’ tregon një lloj narracioni të shkruar përgjatë shekullit të 20-të, i cili ka për qëllim të jetë i ndryshëm nga rrëfimi tradicional, duke përdorur korniza narrative komplekse që refuzojnë prezantim linear apo kronologjik të ngjarjeve fiksonale, si dhe që përdorin personazhe komplekse, akte eksperimentale të të rrëfyerit, zë narrativ joautoritativ, dhe narracion që nxit dyshim për vërtetësinë e vetë narracionit – pra, një tip narracioni i modeluar sipas narracionit modern dhe bashkëkohor të shkruar në gjuhën angleze.

Materiali i përzgjedhur për këtë hulumtim përbëhet nga një sërë veprash të letërsisë angleze dhe amerikane, të cilat mundësojnë aplikimin e principeve teorike të narratologjisë në një analizë

të detajuar të këtyre teksteve, analizë e cila do të linte hapësirë, por edhe do të ofronte mundësi, për të nxjerrë përfundime teorike. Korpusi i disertacionit është:

- Kapitulli i katërt hulumton një narracion tradicional, romanin *Jane Eyre* (1847) të autores Charlotte Brontë;
- Kapitulli i pestë hulumton një narracion modern, romanin *Jazz* (1992) të autores Toni Morrison;
- Kapitulli i gjashtë analizon një numër monologjesh dramatike, duke përfshirë: “Pictor Ignotus” (1845), “Porphyria’s Lover” (1836), dhe “Andrea del Sartro” (1855) nga poeti anglez Robert Browning; duke vazhduar te monologjet dramatike nga Alfred Tennyson, “St. Simeon Stylites” (1833) dhe “Ulysses” (1833); për të kaluar te një monolog dramatik i shekullit të 20-të, “The Love Song of J. Alfred Prufrock” (1915), nga poeti T. S. Eliot. Një analizë krahasimtare e tregimit nga Edgar Allan Poe, “The Cask of Amontillado” (1846) dhe monologut dramatik nga Browning, “My Last Duchess” (1842), ka për qëllim të përvijojë elementet e përbashkëta narrative në të dyja zhanret. Së fundi, elementet narrative të monologut dramatik bashkëkohor do të hulumtohen përmes vëllimit të shkruar nga Carol Ann Duffy, *The World’s Wife* (1999).
- Kapitulli i shtatë teston propozimet e teoricienëve në librin *Optional-Narrator Theory* (2021).

Metoda narrative është përdorur në këtë punim doktrate me qëllim të gjetjes së kontrollimit tekstual të rrëfimit të vetës së parë dhe të monologjet dramatike. Disertacioni ka për qëllim të demonstrojë se një vetëdijësim i lexuesit për metodën narrative është i rëndësishëm jo vetëm për leximin e narrativit në prozën artistike, por edhe për kuptimin e pjesëmarrjes së qenieve njerëzore në biseda të përditshme dhe në shkëmbim të informatave. Metoda narrative si proces e bën studimin e rrëfimitarëve dhe të rrëfimeve të vetës së parë mjaft sfidues meqë në përkufizimin e vazhdueshëm të koncepteve, sikurse koncepti i gjithëdijes së rrëfimitarit, modifikohen edhe llojet e rrëfimitarëve. Si pasojë, principet e rrëfimeve të vetës së parë ndryshojnë në vazhdimësi.

Një hipotezë e punimit propozon se duke pasur parasysh dallimet në mes të narracionit tradicional dhe atij modern, këto dy tipe të rrëfimit do të përdorin strategji të ngjashme por me funksion të ndryshëm të rrëfimit modern. Për më tepër, duke pasur mundësinë të rishikohen

funksionet e elementeve narrative edhe te rrëfimi tradicional, shpesh do të theksohet se duhet të rivlerësohen disa nga strategjitë e përdorura te ky lloj rrëfimi. Për shembull, në rastet kur te rrëfimi i vetës së parë kemi rrëfimtari homodiegetik, shpesh ky lloj rrëfimtari do të përdorë disa strategji për të manipuluar tekstin narrativ duke krijuar iluzion të gjithëdijes dhe distancë kohore në mes të zërit rrëfyes dhe vetë personazhit të tij, pra strategji të cilat lexuesi bashkëkohor duhet medoesmos t'i njohë për të njohur ideologjitë që narrativi ka për qëllim t'i përçojë përmes tekstit. Nga ana tjetër, hulumtimi te narracioni modern ka treguar një rast të një rrëfimtari me pozicion të paqartë në botën narrative, një lloj rrëfimtari të vetës së parë i cili nuk është homodiegetik por e prezanton veten përbrenda aktit të të rrëfyerit, ashtu që nuk shihet qartë nëse është heterodiegetik apo homodiegetik. Për më tepër, ky rrëfimtari i vetës së parë pretendon gjithëdije për botën fiksonale teksa shpesh në tekstin narrativ pranon se ka njohje të kufizuar për ngjarjet fiksonale (shih kapitullin 5 të këtij disertacioni).

Pas kësaj, një hipotezë tjetër e hulumtimit prezanton mundësinë e aplikimit të metodës narrative te leximi i monologut dramatik, një metodë e cila rezulton në një lexim më të saktë të zhanrit, meqë lexuesi merr parasysh zgjedhjet diskursive të folësit, aktin e të rrëfyerit te monologu dramatik, projektimin e një identiteti fiksonal përmes narracionit, si dhe zgjedhjen e një dëgjuesi të caktuar si pranues të tekstit narrativ. Duke njohur këto elemente narrative si strategji të folësit të monologut dramatik, lexuesi aktual mund të arrijë një lexim më të detajuar të kësaj poezie.

Së fundi, kapitulli 7 i këtij disertacioni paraqet një hulumtim i cili teston teorinë më të fundit të narrativit, angl. *optional-narrator theory*, apo teoria e rrëfimtari të padetyrueshëm. Teoricienët që mbështesin këtë teori propozojnë se insistimi për rrëfimtariët si kusht për ekzistencën e narrativit fiksonal është veçse insistim për një sofistikim të analizës letrare. Këta teoricienë thonë se një përqendrim i tepërt te rrëfimtariët fiksonal e zvogëlon rëndësinë e zgjedhjeve artistike dhe aftësive krijuese të autorit. Ata konstatojnë se analizat për gjithëdijen e rrëfimtariëve shpesh mund të arrijnë në pyetje të gabuara dhe të panevojshme rreth dijes së një rrëfimtari që nuk është qenësor për narrativin. Një pikëpamje e tillë mund të ndihmojnë në thjeshtësimin e të kuptuarit të disa teknikave sikurse ligjëratat e zhdrejtë, meqë këta teoricienë do të thoshin se autori i jep rrëfimtariët një dije të caktuar apo qasje në mendjen e personazhit.

Për të testuar disa propozime teorike të kësaj teorie, ky disertacion prezanton një hulumtim origjinal të kryer nga kandidatja gjatë pranverës së vitit 2022. Hulumtimi përdori një pyetësor të

shpërndarë të 90-të studentë bachelori dhe masteri nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, në Fakultet të Filologjisë, në Universitet të Prishtinës. Hulumtimi testoi aftësitë e studentëve-lexuesve për të bërë dallimin në mes të folësit në poezi dhe poetit, si dhe rrëfimarit në prozë dhe romancierit. Hulumtimi bëri pyetje edhe rreth ndikimit të kurseve letrare të dija për folësit në poezi dhe rrëfimtarët në prozë, dmth. nëse orët e letërsisë imponojnë identifikimin e këtyre zërave fikcionalë në letërsi. Më tutje, hulumtimi poashtu testoi nëse përqendrimi te zërat fikcionalë zvogëlon vlerësimin e aftësive krijuese të autorit, dhe nëse orët e letërsisë u ndihmojnë studentëve në rritjen e vlerësimi estetik të veprës letrare. Hulumtimi përfshin të dhëna kuantitative dhe kualitative, andaj statistika inferenciale dhe analiza përmbajtësore janë përdorur së bashku për të mbledhur dhe për të interpretuar të dhënat.

Rezultatet dëshmojnë se studentët e vitit të parë, me një numër të vogël të orëve të letërsisë, nuk mund të bëjnë dallimin në mes të autorit dhe rrëfimtarit. Ndërkaq, hulumtimi tregon se me secilin vit akademik shtesë, ngritet edhe dija për rrëfimtarin si koncept (meqë studentët e vitit të tretë edhe të kartërt dëshmojnë aftësi më të larta në refuzimin e identifikimit të menjëhershëm të rrëfimtarit me autorin). Për më tepër, te studentët e masterit, njohja e teorive sikurse Formalizmi Rus dhe Kritika e Re siç duket kanë ndikuar në krijimin e një llojllojshmërie mendimi apo mospajtimi të përgjigjet e studentëve të masterit, meqë disa prej tyre e shohin rrëfimtarin si qartësisht të dallueshëm nga autori, ndërsa disa të tjerë thonë se rrëfimtari mund të jetë deri në një masë i identifikueshëm me autorin.

Te hulumtimi i njëjtë por me përqendrim te folësi në poezi, rezultatet tregojnë se përgjithësisht një insistim në ekzistencën e folësit në poezi zvogëlon përqendrimin e lexuesit te krijimtaria e autorit. Ky insistim rezultoi në një hutim apo paqartësi të përgjigjet e studentëve meqë, kur u kemi kemi kërkuar ta lexojnë një poezi të caktuar në të cilën teksti nuk dëshmon se ka një folës imagjinar, studentët sipas intuitës e kanë ndërlidhur ekzistencën e mundshme të këtij folësi me poetin, meqë informata rreth poezisë ishte e ndërlidhur me jetën e poetit, Lord Byron-it. Këto rezultate nuk ishin në përputhje me përgjigjet që kishin dhënë studentët në pyetjen e ngjashme *teorike* për folësin në poezi, ku kishin insistuar se folësi imagjinar flet në poezi, e jo poeti. Kjo dëshmon se pavarësisht ekspozimit që kanë ata, dmth. udhëzimit akademik ndaj teorisë dhe kritikës letrare, lexuesi në mënyrë të natyrshme dhe intuitive e përjeton poezinë si krijim të autorit. Në rastin kur përvoja personale e të lexuarit bashkohet me udhëzimet/dijen akademike (e cila në

këtë rast nuk e ka përfshirë teorinë e rrëfimitarit të padetyrueshëm në program), rezultatet dëshmojnë se lexuesi ballafaqohet me paqartësi për teorinë dhe aplikimin e teorisë letrare.

Nga ana tjetër, studentët të cilët ishin më shumë të ekspozuar ndaj udhëzimit/mësidhënies së letërsisë ishin më të vendosur (bazuar nga përqindjet) për të mos pranuar folësin imagjinar si krijues të rimës në poezi. Kjo na tregon se, pavarësisht paqartësive që mund të kenë rreth identifikimit të folësit me poetin, ata kanë zhvilluar një ide të qartë për rolin krijues të poetit. Një rezultat tjetër me interes për këtë hulumtim na tregoi se studentët-lexuesit e kanë më të lehtë të përgjigjen saktë në pyetje teorike për rimën apo metrin në poezi sesa në pyetje praktike, dmth. kur lexojnë një poezi të caktuar. Poashtu, hulumtimi dëshmon se studentët e vitit të tretë dhe të katërt e kanë më të lehtë të bëjnë dallimin në mes të rrëfimitarit dhe autorit sesa folësit imagjinar në poezi dhe poetit, dmth. më qartë e kuptojnë konceptin e rrëfimitarit në prozë.

Ndonëse hulumtimi gjeti një rezultat negativ që vëre nga mësimdhënia akademike në rastin e insistimit të ekzistencës obligative të folësve në poezi dhe rrëfimitarëve në prozë, hulumtimi tregoi edhe një rezultat pozitiv: ekspozimi ndaj veprave letrare dhe teorive letrare përgjatë studimit të letërsisë në nivelin bachelor dhe master, duke nisur nga semestri i dytë dhe tretë (respektivisht, në lëndë si “Poezia e Renesancës” dhe “Romantizmi”) e ka ngritur dhe përmirësuar dijen teorike të studentëve për termet letrare, bazuar në përgjigjet që ata kanë ofruar te përgjigjet e hapura. Së fundi, hulumtimi tregon se shumica e studentëve (92.8%) besojnë se lëndët e letërsisë kanë ndikuar në mënyrën sesi ata i kuptojnë konceptet e folësit në poezi dhe rrëfimitarit në prozë artistike.

Narracioni letrar tradicional dhe modern është diskutuar mjaft në studimet letrare përgjatë shekullit të 20-të dhe vazhdon të studiohet edhe në shekullin e 21-të, mirëpo narratologjia na ofron mundësinë e kuptimit dhe rivlerësimit të elementeve narrative bazuar në hulumtimet më të fundit të prezantuara nga narratologët në konferenca dhe revista narratologjike. Ky disertacion thekson rëndësinë e njohjes së metodës narratologjike në kontrollimin e përmbajtjes narrative. Të njohësh metodat e rrëfimitarëve në tekste narrative do të thotë të krijosh vetëdije ndaj ideologjive që mund të shfaqen në një narracion, një vetëdije që ndihmon në formimin e mendimit kritik dhe vlerësimit autentik të materialit letrar. Këto kanë edhe rëndësi universale meqë studiojnë perceptimin, analizën dhe kuptimbërjen e tekstit letrar dhe të formave të tjera narrative.

Fjalët çelës: strategjitë e kontrollimit narrativ; narrativ i vetës së parë; monolog dramatik; teoria e rrëfimitarit të padetyrueshëm; Brontë; Morrison; Browning; Tennyson; Eliot.

RESUME

This doctoral dissertation explores narrative control through strategies used by first-person narrators in traditional and modern narratives. After the identification of these strategies used to control information delivered through traditional narratives, this research explores whether the same strategies are used in modern narratives. It examines whether these strategies have the same function in modern narratives. Additionally, this dissertation goes beyond the limits of classical narratology in order to propose the possibility of a narrative analysis and the detection of similar narrative strategies in the reading of a poetic genre, the dramatic monologue. In this dissertation, a special emphasis is put on the elements and/or narrative techniques called strategies, which are: creation of a fictional identity, projection of a fictional identity through the narrating act, the emphasis on the narrating act, control of information through paralipsis and prolepsis, narrative duality between the *narrating I* and the *experiencing I*, temporal distance, discursive choices, and mental constructions in the actual reader.

Strategy is defined here as a method or tactic of specific purposes, which is carefully planned by the narrator. The term ‘traditional narrative’ as used in this dissertation refers to the types of narratives written during the 19th century, in which the narrator assumes ownership of the narrating act, uses an authoritative voice throughout the narrative, and in which the narrative follows a chronological order of fictional events, controlled by a narrator who aims at a didactic storytelling – a type of narrative modelled after the Victorian first-person narrative. The term ‘modern narrative’ refers to a type of narrative written through the 20th century which aims at differing from traditional narratives by using complex narrative frames that refuse a linear or chronologic presentation of events, and which use complex characters, complex narrating acts, non-authoritative narrative voices, and narratives that encourage doubt and confusion about the credibility of the narrative itself – i.e. a type of narrative modelled after the modern and contemporary narrative written in English.

The corpus for this dissertation includes a number of literary works out of English and American literature, which make possible the application of theoretical principles of narratology in a detailed analysis of these texts, an analysis which leaves room for theoretical conclusions. The corpus includes:

- The fourth chapter explores a traditional narrative, Charlotte Brontë’s *Jane Eyre* (1847);

- The fifth chapter analyzes a modern narrative, Toni Morrison's *Jazz* (1992);
- The sixth chapter analyzes a number of dramatic monologues, including: Browning's "Pictor Ignotus" (1845), "Porphyria's Lover" (1836), and "Andrea del Sarto" (1855); followed by Tennyson's "St. Simeon Stylites" (1833) and "Ulysses" (1833); moving on to a 20th century dramatic monologue by T. S. Eliot, "The Love Song of J. Alfred Prufrock" (1915). A comparative analysis of Poe's short story "The Cask of Amontillado" (1846) and Browning's dramatic monologue "My Last Duchess" (1842) will aim at delineating the common narrative elements in the two genres. Lastly, the narrative elements of contemporary dramatic monologues will be explored through Carol Ann Duffy's collection, *The World's Wife* (1999).
- The seventh chapter tests the principles proposed by *Optional-Narrator Theory* (2021).

The narrative method has been used in this dissertation with the purpose of detecting textual control in first-person narratives and dramatic monologues. The dissertation aims at demonstrating that a readerly awareness of the narrative method is not only important to the reading of narrative fiction, but also to the process of making sense of daily conversation and exchange of information. The narrative method shows that the study of narrators and first-person narratives is challenging due to the continual process of redefining concepts such as the concept of omniscience which in result changes the definitions of narrators as well. Consequently, the principles of first-person narratives are continually modified.

One hypothesis of the dissertation proposes that the traditional and modern narratives use similar strategies, but that the same strategies have a different function in modern narratives. Moreover, having the opportunity to reconsider the functions of narrative elements in traditional narratives, this research will often aim at putting an emphasis on a reevaluation on some of the strategies used in traditional narratives. For instance, in cases of first-person homodiegetic narrators, it is often evident that the narrator uses some strategies in order to manipulate the narrative text by creating an illusion of omniscience and temporal distance between the narrating voice and the experiencing I, i.e. strategies which a contemporary reader must necessarily know in order to recognize certain ideologies which the narrative aims to deliver through the text. On the other hand, the research on modern narratives has shown the existence of narrators of an unclear position in the narrative world, i.e, a type of first-person narrator who is not homodiegetic

but presents himself/herself within the narrating act, so that it is not clear whether the narrator is homodiegetic or heterodiegetic. Moreover, this first-person narrator assumes omniscience about the fictional world while frequently admitting, in the narrative text, that he/she has limited knowledge about the fictional events (see chapter 5 of this dissertation).

Another hypothesis of this dissertation presents the possibility of applying the narrative method in the reading of dramatic monologues, a method that leads to a more accurate reading of this genre as the reader considers the discursive choices of the speaker, the narrating act in the dramatic monologue, the projection of a fictional self through the narrative, as well as the choice of a type of listener as the receiver of the narrative text. The actual reader can come to a more detailed reading of this genre if these narrative elements of the speaker in the dramatic monologue are recognized as narrative strategies.

Lastly, the 7th chapter of this dissertation presents a research which tests the latest theory of narrative, *optional-narrator theory*. Proponents of this theory propose that an insistence on narrators as prerequisite for the existence of the fictional narrative is merely an insistence on the sophistication of literary analysis. These theoreticians claim that an excessive focus on fictional voices reduces the focus on the importance of the artistic choices and creative skills of the author. They state that analyses of the omniscience of narrators often lead to erroneous questions which are unnecessary to the essence of narrative. Such a perspective can help in simplifying the way readers make sense of some techniques such as free indirect discourse, as adherents of optional-narrator theory would say that the author gives the narrator a specific knowledge or access to the mind of the character.

In order to test some proposals of this theory, this dissertation presents a research conducted by the doctoral candidate in the spring of 2022. The research used a questionnaire distributed to 90 bachelor and master students of the English Language and Literature Department, at the Faculty of Philology, the University of Prishtina. The research tested the skills of students-readers in differentiating between the speaker in poetry and the poet, as well as the narrator in prose and the novelist. It also explored the influence of literature courses on students' knowledge of fictional voices in poetry and narrators in prose, i.e. whether literature courses impose the identification of the existence of these voices in literature. Further, the research also tested whether a focus on fictional voices in poetry and prose lessens the readers' appreciation of the artistic skills of the

author and/or whether these courses help students' aesthetic appreciation of a literary work. The research includes quantitative and qualitative data, thus inferential statistics and content analysis have been used for the gathering and interpretation of data.

The results denote that first-year students, having had a small number of literature courses, cannot make the difference between the author and the narrator. In contrast, the research shows that with each academic year, there is an increasing trajectory of knowledge about the narrator (as third-year and fourth-year students show greater skills in refusing the immediate identification of the narrator with the author). Moreover, knowledge of Russian Formalism and New Criticism in the case of MA students has affected the creation of a diversity or lack of accordance in the MA group, as some see the narrator as entirely distinguishable from the author, whereas others state that the narrator can be identified, to some extent, with the author.

In the same pattern of research but with a focus on fictional voices in poetry, the results show that the insistence on the existence of speakers in poetry moves the attention away from the creative skills of the poet. This insistence resulted in a confusion or lack of clarity on behalf of the students whose answers revealed that when reading an actual poem in which there is no textual evidence of an imaginary speaker, the students use their intuition to relate the existence of this speaker to the poet, as information about the poem was related to Lord Byron's life. These results were not in accordance with the *theoretical* answers the students provided, in which case they insisted that an imaginary voice speaks in a poem. These results reveal that regardless of the amount of academic instruction students received, the reader will naturally and intuitively experience the poem as a creation of the author. In the case where the personal experience of the reader unites with the academic instruction on reading literature (in this case this did not include optional-narrator theory in the BA and MA program), the results denote that the reader faces confusion about theory and its application in the reading of literary works.

In contrast, students that were more exposed to literary instruction were more determined (based on the percentages) to not regard the imaginary speaker as the creator of rhyme in poetry. This shows that they have developed a clearer sense of the role of the poet, regardless of the lack of clarity they may have on the identification of the speaker with the poet. Another important result of this dissertation shows that students-readers find it easier to come to the correct theoretical answer about rhyme or meter in poetry than to the practical one, i.e. reading an actual poem.

Additionally, the research denotes that third-year and fourth-year students can make the difference between the narrator and the author easier than the speaker and the poet in poetry, that is, they understand the concept of narrator better than that of the speaker in poetry.

Although the research presented a negative finding originating from academic instruction in the case of the insistence of an obligatory existence of speakers in poetry and narrators in prose, it also presented a positive result: the exposure to literary works and literary theories throughout the BA and MA studies, starting from the second and third semesters (in courses such as “Poetry of Renaissance” and “Romanticism”, respectively) has enhanced and improved the theoretical knowledge students have about literary terms, based on their answers on the open-ended questions. Lastly, the research revealed that most students (92.8%) believe that literature courses have influenced the way they understand the concepts of speaker in poetry and narrator in prose.

Traditional and modern narratives have been discussed substantially in literary studies throughout the 20th century and continue to be examined in the 21st century, but narratology offers the opportunity to understand and reevaluate narrative elements based on the recent research presented at various conferences and journals on narrative. This dissertation emphasizes the importance of considering the narrative method in the control of narrative content. To know the methods narrators use in narrative texts means to create an awareness of the plausible ideologies conveyed through a narrative, an awareness that helps to build critical thinking and authentic evaluation of a literary text. This also assumes a universal importance as it involves the perception, the analysis and the process of making sense of any literary text and all other fictional and non-fictional narratives.

Key words: strategies of narrative control; first-person fiction; dramatic monologue; optional-narrator theory; Brontë; Morrison; Browning; Tennyson; Eliot.